

VENDIM
Nr. 870, datë 27.12.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I ZONËS RRETH QYTEZËS SË FËMIJËVE, KORÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i zonës rreth Qytezës së Fëmijëve, Korçë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 72 863 295 (shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 72 863 295 (shtatëdhjetë e dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekësh, përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Korçë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë, pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Korçë.

8. Bashkia Korçë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Korçë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Korçë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Korçë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Korçë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I ZONËS RRETH QYTEZËS SË FËMIJEVE, KORÇË”

NR.	PRONARI					VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
						Truall			VLERA TOTALE (lekë)	
		Z. Kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
1	Katerina Teneqexhi, Natasha Teneqexhi Petraq Teneqexhi Rozeta Teneqexhi Elisaveta Teneqexhi Anesti Teneqexhi Ilia Teneqexhi Keti Teneqexhi Romeo Teneqexhi Kostanca Xharo Thoma Xharo Berti Xharo Dhimitraq Teneqexhi Pandeli Teneqexhi Irimi Teneqexhi Ipathia Teneqexhi Kozeta Teneqexhi Dhori Gaqo Teneqexhi	8561	11/70	Truall	1135	1135.0	8537	9,689,495.00	9,689,495.00	Konfirmuar nga ASHK, 013045 urdhër i brendshëm, me vkm 779, datë 24.09.2010, shpronësohet pronari për 365 m2, pasi e zë segmenti rrugor "Unaza Veriore e Korçës".
2	Margarita Tasi Gjika Zhuljeta Angjeli Gjika Dhimitraq Angjeli Gjika Vasillaq Sotiraq Niço Petrina Themistokli Thanas (Gjika) Irimi Themistokli Marko (Gjika) Marjana Themistokli Shtika (Gjika) Ropi Themistokli Gjika Andrea Themistokli GjikaSotiraq Spiro Çekrezi Natasha Spiro Ristollari Vasillaq Spiro Çekrezi Liliana Spiro Seferi Lulinda Spiro Poreçi Gjergji Spiro Çekrezi Nastasi Jani Gjikas Vladimir Spiro Çekrezi	8561	1/874	Truall	7400	7400.0	8537	63,173,800.00	63,173,800.00	Konfirmuar nga ASHK
VLERA TOTALE									72,863,295.00	